

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË " FA-TECH " SH.P.K.

Sot, me datë 07/10/2024

Florentin Ahmetaj, shtetas Shqiptar, lindur më 29/10/1980 në Fier, Shqipëri, mbajtës i Kartes ID me nr personal I01029033Q madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**FA-TECH**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**FA-TECH**" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, adresën: **Rruga Mustafa Haska, godine 1 kateshe numer pasurie 3/757 ZK 8240 Tirane Shqipëri.**

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Tregtim i pajisjeve elektronike. Krijimi i linjave për montimin e kompjuterave dhe studiove dixhitale. Sigurimi i pjeseve të kembimit për të gjitha llojet e pajisjeve të tilla dhe realizimi i shërbimit të mirembajtjes, garancisë e të riparimit. Realizimi i projektimit dhe instalimit të sistemeve elektronike të sigurisë kibernetike, elektrike dhe të sigurisë së ndërtesave. Implementim i sistemeve dhe programeve informatike (software-ve), mirembajtje të sistemeve dhe programeve informatike, asistencë dhe konsulence për përgatitjen e programeve informatike (software-ve). Shërbime Marketingu dhe telemarketingu, Shërbime ndërmjetësimi biznesi, PR marrëdhënie me publikun.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5



KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 200.000 Lek dhe është i ndarë në 1 kuote.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Florentin Ahmetaj** zoteron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 200,000 Lek dhe 200,000 Lek të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Florentin Ahmetaj**, shtetas Shqiptar, lindur më 29/10/1980 në Fier, Shqipëri, me ID I01029033Q, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

ORTAKU THEMELUES

Florentin Ahmetaj

Florentin Ahmetaj
